

**VENDIM**  
**Nr. 108/2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 55/2014 “PËR  
MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË  
POZICIONEVE TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT E  
KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Lidhja nr. 1 (struktura) e vendimit të Kuvendit nr. 55/2014, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.


II. Lidhja nr. 2 (organika) e vendimit të Kuvendit nr. 55/2014, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 21.12.2015

**STRUKTURA**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**



**ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË  
TË DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE**

| <b>Funksioni</b>                                                                               | <b>Nr. i punonjësve /Kategoria/klasa</b> |                               |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|-------------------------------|
| <b>I. Inspektori i Përgjithshëm</b>                                                            | 1                                        | Ligj nr. 9584, datë 17.7.2006 |
| <b>II. Kabineti</b>                                                                            |                                          |                               |
| Drejtor Kabineti                                                                               | 1                                        | II-a                          |
| Këshilltar                                                                                     | 1                                        | II-b                          |
| Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm                                                         | 1                                        | VKM                           |
| <b>III. Sekretari i Përgjithshëm</b>                                                           | 1                                        | I-b                           |
| <b>IV. Inspektorë</b>                                                                          |                                          |                               |
| Inspektorë                                                                                     | 15                                       | II-a                          |
| Ndihmësinpektorë                                                                               | 12                                       | II-b                          |
| <b>V. Drejtoria e Kontrollit Paraprak, Aritmetik-Logjik<br/>dhe e Konfliktit të Interesave</b> |                                          |                               |
| Drejtor                                                                                        | 1                                        | II-b                          |
| Specialistë                                                                                    | 4                                        | III-b                         |
| <b>VI. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me<br/>Institucionet</b>                         |                                          |                               |
| Drejtor                                                                                        | 1                                        | II-b                          |
| <b>VI/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet<br/>Përgjegjëse</b>                            |                                          |                               |
| Përgjegjës sektori                                                                             | 1                                        | III-a                         |
| Specialistë                                                                                    | 3                                        | III-b                         |
| <b>VI/2. Sektori i Këshillimit Juridik</b>                                                     |                                          |                               |
| Specialistë                                                                                    | 2                                        | III-b                         |
| <b>VII. Drejtoria e Financave dhe Administrimit</b>                                            |                                          |                               |
| Drejtor                                                                                        | 1                                        | II-b                          |
| <b>VII/1. Sektori i Administrimit të IT-së</b>                                                 |                                          |                               |
| Përgjegjës sektori                                                                             | 1                                        | III-a                         |
| Specialistë                                                                                    | 2                                        | III-b                         |
| <b>VII/2. Sektori i Protokoll-Arkivit dhe Administrimit<br/>të Deklaratave të Pasurisë</b>     |                                          |                               |
| Përgjegjës sektori                                                                             | 1                                        | III-a                         |
| Specialistë                                                                                    | 4                                        | III-b                         |
| <b>VII/3. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhetit</b>                                      |                                          |                               |
| Specialist finance                                                                             | 1                                        | IV-a                          |
| Specialist buxheti                                                                             | 1                                        | III-b                         |
| Magaznier                                                                                      | 1                                        | VI                            |
| Shofer                                                                                         | 1                                        | IV                            |
| Receptionist                                                                                   | 1                                        | III                           |
| Pastruese                                                                                      | 2                                        | I                             |
| <b>Gjithsej</b>                                                                                | <b>60 punonjës</b>                       |                               |